



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE



Nr. 45 Prot.

Tiranë më 2 / 2 /2015

Proces-verbal

Mbledhja e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së

Sot, në datën 2.2.2015 në orën 17:00, në ambientet e përkohshme të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) u mbajt mbledhja e radhës e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së. Rendi i ditës, sipas njëlistimit paraprak të Kryetarit të Bordit parashikonte:

1. Dëgjuesë e Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC-së lidhur me feedback-un e marrë nga procesi konsultativ me OJF-të si edhe një listim i prioritetëve të nxjerra nga ky proces.
2. Diskutim rreth prioritetëve të thirrjes për vitin 2015, duke konsideruar prioritetet e parashikuara me ligj si edhe sugjerimet e mbledhura pas procesit konsultativ me OJF-të. Pas diskutimit, përcaktimi i prioritetëve të Thirrjes për 2015 dhe publikim i tyre.
3. Shpalljen e Thirrjes për vitin 2015.
4. Të tjera.

Duke konsideruar situatën e rënduar në jug të vendit për shkak të përmbytjeve, anëtar i Bordit Aldo Merkoci sugjeron që të futet në rendin e ditës edhe kjo temë në pikën 4.

Diskutimin rreth situatës së rënduar aktuale në jug dhe në juglindje të Shqipërisë si edhe ndërmarrjen e një fushate sensibilizuese me OJF-të, por jo vetëm, për të ofruar ndihmë për zonat e përmbytura.

Anëtar i Bordit Ismail Ademi propozon gjithashtu nismën për ngritjen e një fondi emergjence në ndihmë të këtyrë zonave dhe kërkon edhe kontributin në nivel individual të anëtarëve të Bordit.

Verifikohet prania e Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC-së z. Andi Kananaj, si edhe anëtarëve të Bordit si më poshtë:

1. Z. Adrian THANO
2. Z. Ismail ADEMI
3. Z. Alban DUDUSHI
4. Z. Aldo MERKOCI
5. Znj. Gelardina PRODANI

Kryetari i BM, z. Adrian Thano, pasi verifikon se është plotësuar kuorimi i nevojshëm, deklaron të hapur mbledhjen rreth orës 17:00 të mbasdites.

Në vijimësi të mbledhjes rreth pikës 1 të rendit të ditës Kryetari i Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së z. Adrian Thano i dha fjalën z. Andi Kananaj, Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC-së për të bërë një raportim lidhur me rezultatet e procesit konsultativ që u zhvillua me OJF-të me qëllim dhënien e sugjerimeve rreth prioritetëve të Thirrjes së radhës.

Z. Andi Kananaj u shpreh: *"Agjencia për Mbeshtetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) në Bashkëpunim të ngushtë me Delegacionin e Bashkimit Evropian, Zyrën pranë Kryeministrit dhe TACSO Albania zhvilloi me datë 26.01.2015, konsultimin me shoqërinë civile rreth prioritetëve të thirrjes së radhës nr. 7.*

Ky takim u organizua në ambientet e EU Info Centre dhe ishte vazhdimësia e një serie konsultimi të nisur online që në datë 15.01.2015, nëpërmjet një formati elektronik, ku OJF-të japin mendimet dhe sugjerimet e tyre, proces i cili u përmbyll më datë 28.01.2015. Takimi kishte si qëllim thithjen e të gjitha mendimeve dhe sugjerimeve të tyre lidhur me fushat prioritare që duhet të përfshihen në këtë thirrje.

Në këtë takim u bë një përshkrim i shkurtër rreth rolit dhe rëndësisë së forcimit të bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile, për të rritur ndikimin dhe qëndrueshmërinë në punën e përbashkët.

Më pas fjalën e mori z. Stefano Calabretta, përfaqësuesi i Delegacionit të BE-së për Shoqërinë Civile dhe të Drejtat e Njeriut, i cili shpjegoi fillimin e bashkëpunimit midis AMSHC-së dhe strukturave të Delegacionit të BE-së, të cilat përkrahin shoqërinë civile në Shqipëri.

Në vazhdim foli znj. Evis Quja, koordinatore në Departamentin e Programimit të Zhvillimit të Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, pranë Zyrës së Kryeministrit, z. Genci Pasko, drejtor i programit TACSO, si dhe znj. Kozara Kati, në cilësinë e anëtares së Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së.

Për këtë takim pati një interes të madh, tregues i të cilit ishte pjesëmarrja e lartë e përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë që operojnë në sektorin e shoqërisë civile në mbarë vendin. Numri i pjesëmarrësve me aprovim elektronik ishte rreth 199 OJF. Cijatë periudhës së

mbledhjes së sugjerimeve u grumbulluan rreth 12 sugjerime në format elektronik si edhe 31 sugjerime në sallë. Shifra e pjesëmarrësve në sallë arriti rreth 100 pjesëmarrës gjatë zhvillimit të takimit konsultativ. Për shkak të pjesëmarrjes të lartë, Agjencia mbajti edhe një seancë të dytë konsultimi me shoqërinë civile nga ora 14.00-16.00 ku pati një numër prej afërsisht 10 OJF pjesëmarrëse.

Në mbyllje të takimit, pjesëmarrësit shprehën mendimet dhe sugjerimet e tyre rreth fushave prioritare për thirrjen e radhës, të cilat i gjeni të përmbledhura dhe artikuluar në formë prioritetesh të propozuara për thirrjen si më poshtë:

1. Mbështetje e nismave që ndikojnë në përmirësimin e kushteve të personave me aftësi të kufizuara, përfshi këtu fuqizimin e kapaciteteve profesionale dhe përditësimin e operatorëve, sensibilizimin e shoqërisë dhe rritjen e ndjeshmërisë ndaj kësaj kategorie;
2. Promovimi i nismave të qeverisjes së mirë, përfshi këtu luftën ndaj korrupsionit, zhvillimin e demokracisë dhe pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të qytetarëve në politikbërje;
3. Promovimi dhe integrimi shoqëror i komunitetit rom dhe pakicave të tjera të pranishme në Shqipëri;
4. Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile, kryesisht ato të sapoformuara, të drejtuara nga të rinj dhe me aktivitete e seli në zonat periferike të Shqipërisë;
5. Fuqizimi i barazisë gjinore, luftës kundër diskriminimeve që rrjedhin nga seksi, raca apo bindje të tjera personale;
6. Fuqizimi i nismave që kanë si objekt mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e ndërgjegjshmërisë ambientaliste të qytetarëve, kryesisht të rinjve;
7. Forcimi i institucionit të tolerancës dhe dialogut si vlera themelore të demokracisë (të drejtat e njeriut, lufta kundër dhunës dhe diskriminimit, diversiteti si vlerë dhe pasuri për një shoqëri demokratike);
8. Fuqizimi i vullnetarizmit, sidomos atij rinor, si edhe lidhjeve me partnerë rajonalë dhe ndërkombëtarë në këtë sektor;
9. Fuqizimi i nismave kulturore dhe artistike që krijojnë vlerë të shtuar për kontekstin social dhe zhvillimin e sinergjive brenda shoqërisë civile.

Takimi u vlerësua nga pjesëmarrësit, të cilët kërkuar organizime të takimeve të tilla konsultative midis aktorëve të interesuar për këtë sektor si edhe dëshirën për të pasur edhe në të ardhmen mundësi bashkëpunimi dhe shkëmbime mendimesh midis Qeverisë, Shoqërisë Civile dhe Zyrës së Bashkimit Evropian."

Në përfundim të dëgjësës dhe raportimit të Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC-së lidhur me rezultatet e procesit konsultativ me OJF-të si edhe me listimin e fushave prioritare të dala nga ky proces, anëtarët e Bordit të pranishëm në këtë mbledhje, vazhduan diskutimin e pikës 2 të rendit të ditës lidhur me përcaktimin e prioriteteve përfundimtare të Thirrjes për vitin 2015.

Pas konsultimeve dhe diskutimeve të përbashkëta, duke marrë parasysh prioritetet e sugjeruara nga OJF-të dhe të artikuara si më sipër, në mbështetje të legjislacionit dhe misionit të AMSHC-së, si edhe në përputhje me prioritetet qeveritare, u vendos që prioritetet e Thirrjes Nr. 7 të jenë si më poshtë vijon:

1. Mbështetje e nismave që ndikojnë në përmirësimin e kushteve të personave me aftësi të kufizuar, përfshi këtu fuqizimin e kapaciteteve profesionale dhe përditësimin e operatorëve, sensibilizimin e shoqërisë dhe rritjen e ndjeshmërisë ndaj kësaj kategorie;
2. Promovimi i nismave të qeverisjes së mirë, përfshi këtu luftën ndaj korrupsionit, zhvillimin e demokracisë dhe pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të qytetarëve në politikbërje;
3. Promovimi dhe integrimi shoqëror i komunitetit rom dhe pakicave të tjera të pranishme në Shqipëri;
4. Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile, kryesisht ato të sapoformuara, të drejtuara nga të rinj dhe me aktivitete e seli në zonat periferike të Shqipërisë;
5. Fuqizimi i barazisë gjinore, luftës kundër diskriminimeve që rrjedhin nga seksi, raca apo hindje të tjera personale;
6. Fuqizimi i nismave që kanë si objektiv mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e ndërgjegjshmërisë ambientaliste të qytetarëve, kryesisht të rinjve;
7. Forcimi i institucionit të tolerancës dhe dialogut si vlera themelore të demokracisë (të drejtat e njeriut, lufta kundër dhunës dhe diskriminimit, diversiteti si vlerë dhe pasuri për një shoqëri demokratike);
8. Fuqizimi i vullnetarizmit, sidomos atij rinor, si edhe lidhjeve me partnerë rajonalë dhe ndërkombëtarë në këtë sektor;
9. Fuqizimi i nismave kulturore dhe artistike që krijojnë vlerë të shtuar për kontekstin social dhe zhvillimin e sinergjive brenda shoqërisë civile

Pas përcaktimit të prioriteteve përfundimtare të dala për Thirrjen Nr. 7, anëtarët e Bordit, duke ndjekur vendimin e mbledhjes së datës 15.1.2015 me Nr 24 Prot që 20% e shumës së destinuar,

të jetë për projekte të kofinancuara edhe nga donatorë të huaj të rëndësishëm, i sugjeruan Drejtorit Ekzekutiv edhe nevojën për ndryshimin e formularit dhe buxhetit i cili duhet të jetë në dy modele në varësi të llojit të projektit. (Formulari i tipit A, në rastin e projekteve normale si edhe formulari i tipit B, në rastin e projekteve me bashkëfinancim).

Diskutimi i mësipërm synonte përpjekjet për ndryshime në zhvillimin dhe shtrirjen e projektit, thjeshtëzimin dhe përshtatjen e formularit si edhe mundësinë për një kontroll të dyfishtë mbi përdorimin e duhur të fondeve të dhëna nga AMSHC për OJF-të fituese.

Anëtarët e pranishëm në këtë mbledhje vijuan diskutimin në lidhje me pikën 3 të rendit të ditës dhe ranë dakord për shpalljen dhe publikimin e Thirrjes së radhës, Thirrjen Nr. 7.

Në lidhje me pikën e shtuar të rendit të ditës, nismën e menjëhershme të një fushate sensibilizuese me OJF-të si edhe koordinimin e punës mes tyre për të ofruar ndihma për zonat e përmbytura Kryetari Ithano në mbështetje të propozimeve të anëtarëve Merkoci dhe Ademi vijon:

"Duke pasur parasysh rendin e ditës për këtë mbledhje në lidhje me situatën e rënduar aktuale, mbështes propozimet e z.Merkoci dhe z.Ademi. Përveç punës koordinuese me OJF-të për të grumbulluar dhe shpërndarë ndihmat e mundshme, të ndërmarrim edhe nismën për të ngritur një fond të menjëhershëm në nivel Bordi për t'u gjendur pranë dhe për të kontribuar sadopak në situatën e rënduar në zonat e përmbytura. Sugjeroj që kjo nismë të realizohet sa më shpejt duke pasur parasysh situatën emergjente të nevojave që kanë banorët në zonat e përmbytura. Mund të diskutojmë dhe të japim sugjerime së bashku për mënyrën sesi mund të realizohet sa më mirë kjo nismë."

Z.Aldo Merkoci u shpreh: *"Duhet të bëjmë një koordinim shumë të mirë me OJF-të si edhe t'i njoftojmë ato me e-maile. Ndërkohë duhet të përgatisim një deklaratë për shtyp si edhe njoftimet në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale edhe me banera krahas tekstit të njoftimit."*

Znj.Gelardina Prodani informoi Kryetarin dhe anëtarët e tjerë të Bordit për kontaktet e Shtabit të Emergjencave dhe procedurat e shpërndarjes së ndihmave.

Të gjithë anëtarët e pranishëm në këtë mbledhje shprehën dakordësinë e tyre në lidhje me propozimet e mësipërme si edhe diskutuan mundësinë e bashkëpunimit me Shtabin e Emergjencave me qëllim që të realizohet grumbullimi dhe shpërndarja e këtyre ndihmave.

Të gjithë anëtarët e Bordit shprehën vullnetin dhe vendosën në dispozicion kohën e tyre për të qenë pjesë e këtij aksioni i cili do e shikojë AMSHC-në në vijë të parë për të ndihmuar komunitetet e prekura nga përmbytjet.

Në përfundim të mbledhjes, Kryetari i Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së hodhi në vota vendimet e nxjerra nga kjo mbledhje të cilat janë si më poshtë vijon:

- 
1. Përcaktimi përfundimtar i prioriteteve të Thirrjes Nr. 7 në përputhje me prioritetet qeveritare, si edhe duke marrë parasysh prioritetet e dalë nga procesi konsultativ me OJF-të.
 2. Shpallja dhe publikimi i Thirrjes Nr. 7.
 3. Ndryshimi i formularit të aplikimit në rastet e projekteve me bashkëfinancim nga AMSHC dhe donatorë të tjerë.
 4. Nisma e një fushate sensibilizuese me OJF-të për të ndërmarrë një aksion të koordinuar ndihmash për zonat e përmbytura dhe ngritja e një fondi të financuar nga shpërblimet e anëtarëve të Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së për t'u ardhur në ndihmë komuniteteve të zonave të përmbytura.

Të gjithë anëtarët e pranishëm aprovuan në unanimitet vendimet e propozuara.

Mbledhja u mbyll në orën 18:30.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHQËRISË CIVILE

Adrian THANO

Kryetar i Bordit Mbikqyrës

Majlinda DHUKA

Nënkryetare e Bordit Mbikqyrës

Alban DUDUŠHI

Anetar

Albana KOCIU

Anëtare

Aldo MERKOCI

Anetar

Endri FUGA

Anetar

Gelardina PRODANI

Anëtare

TIRANE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Ismail ADEMI

Ismail Ademi

Anëtar

Kozara KATI

Anëtare

